



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 80-të të mbajtur më 23.01.2023 ka miratuar sa vijon

VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr. 09-4001/1 datë 21.04.2022, e formuar në bazë të denoncimit nga një parashtrues i njohur kundër personit ///, drejtor i ///, **NDËRPRITET.**

KSHPK konstatoi se pretendimet në denoncim nuk vërtetohen, gjegjësisht nuk ka shkelje të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas të cilit KSHPK-ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-3430/1 datë 07.04.2022 është formuar në bazë të denoncimit nga një parashtrues i njohur dhe fillimisht është ndarë dhe vënë në punë në njësinë për parandalimin e korrupsionit. Në denoncim thuhet se personi i treguar ka qenë njëkohësisht drejtor në /// dhe një nga themeluesit e ///, e cila ka marrë fonde dhe projekte në fushën e mjedisit nga ///.

Në kërkesë gjithashtu thuhet se djali /// ishte drejtor i kompanisë, i lidhur tërthorazi me një shoqatë tjetër, përkatësisht ///, e cila gjithashtu mori fonde nga e njëjta ministri

Nga pretendimet në denoncim rezulton se nuk ka pretendime konkrete për keqpërdorim të pozitës zyrtare nga ana e zyrtarit për të cilin do të vepronte njësia për parandalimin e korrupsionit dhe për shkak se pretendimet në denoncim i referohen një situatë që inicicion ekzistimin e konfliktit të interesave, lënda me numër 12-3430/1 datë 07.04.2022, është shpërndarë dhe ka vazhduar punën në Njësinë e Parandalimit të Konfliktit të Interesit me numër 09-4001/1 datë 21.04.2022.

Duke marrë parasysh pretendimet në denoncim, se drejtori i ///, e cila ka pranuar mjete dhe projekte nga ///, si dhe se djali i drejtorit ishte drejtor i ndërmarrjes, i lidhur indirekt me një shoqatë tjetër, gjegjësisht shoqatën malore ///, e cila po ashtu merrte mjete nga e njëjta ministri, KSHPK-ja në përputhje me kompetencat e parapara në nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i janë drejtuar Ministrisë së Mjedisit Jetësorë, me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike.

KSHPK-ja kërkoi të dhëna dhe informacion nga Ministria nëse janë paguar fonde për aktivitete dhe projekte në fushën e mjedisit jetësor për:

- Shoqata e qytetarëve të fshatit /// dhe Shoqata sportive rekreative /// / gjatë periudhës kur për drejtor të /// është emëruar personi ///.
- Nëse pagesat e tilla janë kryer, duhet të dorëzohet i gjithë dokumentacioni për procedurat e zbatuara për dhënien e granteve dhe disbursimit të burimeve financiare shoqatave për aktivitete dhe projekte gjatë asaj periudhe.

Nga Ministria e Mjedisit jetësor është marrë një përgjigje pas një kërkesë për të dhëna dhe informacione, në të cilën thuhet se /// , në kuadër të Konkursit për ndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera në fushën e mjedisit jetësor për vitin 2021 (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 28/2021 më 02.02.2021) ka dorëzuar Kërkesë për financim të projekt propozimit ///, Statuti i shoqatës dhe Deklarata e mos ekzistencës së konfliktit të interesit (me anëtarë të komisionit jurie dhe me drejtues/zyrtarë të emëruar në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës) me nënshkrim dhe vulë të ///. Sipas dokumenteve të përmendura, drejtori i /// nuk është pjesë e strukturës menaxhuese të shoqatës. Prandaj, është nënshkruar marrëveshje me nr. /// të datës /// në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës dhe Shoqatës për ndarjen e mjeteve për realizimin e projektit në vlerë prej /// denarë. Në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së nënshkruar, Shoqata ka realizuar projektin gjatë vitit 2021, për të cilin janë dorëzuar raporte të plota për zbatimin e plotë të projektit “///”. Si rezultat i sa më sipër, Ministria veproi ndaj pagesës së projektit, për të cilin ka statusin e projektit **E përfunduar/paguar.”**

“Shoqata sportive dhe rekreative /// ka paraqitur kërkesë për financim të projektit me nr. /// të datës /// nga Konkursi për ndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera në fushën e mjedisit jetësor për vitin 2021 (Gazeta Zyrtare e RMV-së Nr. /// më ///. viti ///), plotësuar me Vendim nga Regjistri Qendror numër /// datë ///, Statuti i shoqatës dhe Deklarimi i mosekzistencës së konfliktit të interesit (me anëtarë të komisionit jurie dhe me drejtues/zyrtarë të emëruar në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës) me nënshkrimin dhe vulën e ///.”

Në përgjigjen e Ministrisë, thuhet se pas konstatimit të situatës se personi ///, drejtor i ///, është pjesë e strukturës menaxhuese të shoqatës ///, Ministria nuk vepron në nënshkrimin e Marrëveshjes për ndarjen e fondeve me të.

Nga kjo, siç deklarojnë vetë ata, del se nuk janë bërë pagesa të mjeteve financiare për Shoqatën ///.

Duke marrë parasysh pretendimet në përgjigjen e paraqitur nga Ministria e Mjedisit, Komisioni Shtetëror, në përputhje me kompetencat e tij, ka kryer një inspektim në sistemin e shpërndarjes së Regjistrit Qendror të RMV-së më datë 14.12.2022 dhe ka konstatuar se në sistemin e Regjistrit Qendror është regjistruar ndryshimi i themeluesve, kështu që informacioni për pronarin e shoqatës /// është fshirë.

Nga kjo konstatohet se në momentin kur shoqata sportive dhe rekreative /// ka paraqitur kërkesë për financim të projektit me nr. /// të datës /// nga Konkursi për ndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera në fushën e mjedisit jetësor për vitin 2021, si pronar i shoqatës është paraqitur personi /// dhe njëkohësisht ka qenë edhe drejtor i ///.

Ndryshimi i themeluesve në Regjistrin Qendror të RMV-së është kryer më ///.

Megjithatë, duke marrë parasysh pretendimet në përgjigjen e paraqitur nga Ministria, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur përgjigjes, KSHPK-ja konstatoi se Ministria nuk kishte lidhur marrëveshje me shoqatën e sipërpërmendur dhe se nuk kishte paguar mjete financiare. ndaj saj.

Pra, rezulton se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për shkelje të dispozitave ligjore, nuk vërtetohen pretendimet për konflikt interesi, sepse janë ndërmarrë veprime me të cilën nuk është lidhur marrëveshje me shoqatën kontestues dhe janë shmangur efektet negative nga realizimi i saj.

Nga sa u tha më sipër, Komisioni Shtetëror nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm në këtë rast, për çka seanca e mbajtur më 18 janar 2023 vendosi si në dispozitiv të vendimit.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar,
Vladimir Georgiev

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së
Përgatiti: E.N, Këshilltar
Kontrolloi: K.Z., Udhëheqëse
Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

